



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.61

26 maj

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.6547 datë 11.5.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 2303
Vendim i BSH nr.25, datë 24.3.2010	Për miratimin e rregullores “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka” 2303
Vendim i BSH nr.26, datë 14.4.2010	Për miratimin e “Sistemit raportues për subjektet financiare jobanka” 2312

DEKRET
Nr.6547, datë 11.5.2010

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të Kushtetutës, të nenit 9, pika 7, nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998, “Për shtetësinë shqiptare”,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij

z. Veton Gani Çelaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.25, datë 24.3.2010

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË
VEPRIMTARINË E SUBJEKTEVE FINANCIARE JOBANKA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit European dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja “Për normat e mbikëqyrjes të subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.60, datë 5.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani
2303

RREGULLORE

PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË VEPRIMTARINË E SUBJEKTEVE FINANCIARE JOBANKA

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka.

Neni 2 **Baza juridike**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 1, pika 4, shkronja “b” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b) nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i cili më poshtë në këtë rregullore do të quhet “ligji për bankat.”

Neni 3 **Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë subjektet financiare jobanka dhe institucionet financiare të mikrokredisë, të licencuar për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4 **Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për bankat dhe në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

- a) “Kapital” është shuma algjebrike e elementeve të mëposhtme të bilancit:
 - i) kapital i paguar,
 - ii) primet e aksioneve,
 - iii) rezervat,
 - iv) diferenca rivlerësimi,
 - v) fitimet e pashpërndara, dhe
 - vi) fitim humbja e vitit ushtrimor;
- b) “Kredi me probleme” është totali i kredisë (kryegjë dhe interes) të klasifikuar në tre kategoritë e fundit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje;
- c) “Kredi me probleme neto” është totali i kredisë me probleme (kryegjë dhe interes) duke zbritur fondin rezervë të krijuar për mbulimin e humbjeve nga këto kredi.

KREU II
ADMINISTRIMI I RREZIKUT NË SUBJEKTET
QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E KREDIDHËNIES

NËNKREU I
EKSPOZIMI NDAJ RREZIKUT DHE KUFIZIMET

Neni 5

Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit

1. Subjekti, për ushtrimin e veprimtarisë së sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të tij gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie, siguron nivele të mjaftueshme të kapitalit.

2. Subjekti respekton në çdo kohë treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, siç përcaktohet në raportet e mëposhtme:

a) raporti i kapitalit me totalin e aktiveve, nuk duhet të jetë më pak se 5% (pesë për qind) në vitin e parë të veprimtarisë, 8% (tetë për qind) në vitin e dytë dhe 10% (dhjetë për qind) në vazhdim;

b) raporti i kapitalit me totalin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara (neto), nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);

c) raporti i kapitalit me totalin e kredive me probleme (neto), nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind).

Neni 6

Ekspozimi ndaj rrezikut dhe kufizimet

1. Subjekti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, përcakton kriteret dhe harton metodat e procedurat për identifikimin dhe monitorimin e të gjitha rreziqeve në përputhje me aktet e brendshme të subjektit dhe aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë.

2. Subjekti respekton në çdo kohë treguesit e ekspozimit ndaj rrezikut/qeve, siç përcaktohet në raportet e mëposhtme:

a) raporti i kredive me probleme me totalin e kredive, nuk duhet të jetë më shumë se 10% (dhjetë për qind);

b) raporti i kredive të fshira (duke zbritur arkëtimet) me tepricën mesatare të kredive, për çdo periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore nuk duhet të jetë më shumë se 3% (tre për qind);

c) raporti i aktiveve të qëndrueshme (neto) mbi totalin e aktiveve, nuk duhet të jetë më shumë se 20% (njëzet për qind) në vitin e parë të veprimtarisë dhe nuk duhet të jetë më shumë se 10% (dhjetë për qind) mbas vitit të parë të veprimtarisë;

d) raporti i aktiveve që sjellin të ardhura me detyrimet që shkaktojnë shpenzime, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);

e) raporti i kredisë me totalin e aktiveve të subjektit, nuk duhet të jetë më shumë se 95% (nëntëdhjetë e pesë për qind);

f) çdo investim në tituj, me përjashtim të investimeve në titujt e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe titujve të emetuar nga qeveritë dhe/ose bankat qendrore të vendeve të OECD, nuk duhet të tejkalojë 5% (pesë për qind) të kapitalit të subjektit;

g) totali i investimeve mbi tituj, me përjashtim të investimeve në titujt e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe titujve të emetuar nga qeveritë dhe/ose bankat qendrore të vendeve të OECD, nuk duhet të tejkalojë 40% (dyzetë për qind) të kapitalit të subjektit.

Neni 7

Ekspozimi maksimal i lejueshëm

1. Ekspozimi i subjektit ndaj një personi ose një pale të tretë është shuma e të gjitha marrëdhënieve në aktiv të bilancit dhe të angazhimeve jashtë bilancit me këtë person ose kundërpartit dhe personave të lidhur me të.

2. Ekspozimi i subjektit ndaj një personi ose grupi personash të lidhur konsiderohet ekspozim i madh kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 10% (dhjetë për qind) e kapitalit të subjektit.

3. Ekspozimi i subjektit ndaj një personi ose grupi personash të lidhur nuk mund të tejkalojë 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të kapitalit të subjektit.

4. Subjekti nuk merr përsipër ekspozime të mëdha, të cilat të marra së bashku tejkalojnë 600% (gjashtëqind për qind) të kapitalit të subjektit.

5. Në ekspozimin e subjektit ndaj një personi nuk përfshihen:

a) pretendimet që rrjedhin nga marrëdhëniet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, të siguruara me barrë me një depozitë monetare, deri në shumën e kësaj barre siguroese;

b) letrat me vlerë të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose të Bankës së Shqipërisë apo një garanci e patjetërsueshme e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

6. Subjektet hartojnë procedura administrative dhe kontabël, si dhe mekanizma të kontrollit të brendshëm për të identifikuar, regjistruar dhe monitoruar të gjitha ekspozimet e mëdha dhe ndryshimet e tyre.

Neni 8

Rreziku i likuiditetit

1. Rreziku i likuiditetit është mundësia e humbjes financiare si rezultat i mungesës së aktiveve likuide të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet kur ato maturohen dhe kërkohen, dhe/ose kur subjekti nuk ka mundësi të financojë rritjen e aktiveve të veta.

2. Subjektet krijojnë sistemin e administrimit të rrezikut të likuiditetit, i cili ka për qëllim miradministrimin e rrezikut të likuiditetit. Ky sistem përfshin minimalisht strategjinë dhe politikat për administrimin e rrezikut të likuiditetit, strukturën organizative të krijuar për administrimin e rrezikut të likuiditetit, sistemin e kontrollit të brendshëm, sistemin e administrimit të informacionit etj.

3. Subjektet sigurojnë që sistemi i administrimit të rrezikut të likuiditetit, në mënyrë sasiore dhe cilësore, të jetë në përputhje me madhësinë e subjektit, tipologjinë e veprimtarisë së tij dhe nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit.

4. Subjekti respekton në çdo kohë treguesit e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit, siç përcaktohet në raportet e mëposhtme:

a) raporti i aktiveve me maturim të mbetur njëmuor ndaj detyrimeve me maturim të mbetur njëmuor, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);

b) raporti i aktiveve me maturim të mbetur tremujor ndaj detyrimeve me maturim të mbetur tremujor, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);

c) raporti i tepicës së kredive me afat maturimi të mbetur më shumë se dy vjet me burimet e financimit me afat maturimi të mbetur mbi dy vjet, nuk duhet të jetë më shumë se 100% (njëqind për qind).

Neni 9

Normat e lejueshme për pozicionet e hapura valutore

1. Pozicioni i hapur valutore në një valutë të caktuar përfaqëson shumën ekuivalente në lekë të diferencës midis të drejtave dhe detyrimeve gjithsej të subjektit në këtë valutë.

2. Subjektet nuk duhet të tejkalojnë në fund të çdo dite pune normat e mëposhtme për pozicionet e hapura në valutë:

a) raporti i pozicionit të hapur valutor për një monedhë me kapitalin, nuk duhet të jetë më shumë se 20% (njëzet për qind); dhe

b) raporti i pozicionit të hapur valutor për të gjitha monedhat me kapitalin, nuk duhet të jetë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit.

Neni 10

Rreziku i kredisë

1. Subjektet financiare jobanka miratojnë dokumentet e strategjive, politikave, procedurave dhe rregullave të brendshme për monitorimin dhe kontrollin në vazhdimësi të cilësisë së portofolit të kredisë dhe të aktiveve të tjera.

2. Dokumentet e parashikuar në pikën 1 të këtij neni përmbajnë/përfshijnë minimalisht:

a) strategjinë e kreditimit sipas periudhave, duke përfshirë objektiva realiste në lidhje me zgjerimin e portofolit të kredisë, përbërjen e tij sipas sektorëve, sipas gjeografisë, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.;

b) politikat e normave të interesit, të afateve, të shlyerjeve dhe të madhësisë së kredive;

c) rregullat e vendosur për njohjen dhe analizën e kredimarrësit dhe/ose të garantuesit të kredisë;

d) procedurat për dokumentacionin e nevojshëm që duhet plotësuar për dhënien e kredive, si edhe për miratimin e kredisë, sipas hierarkisë;

e) politikat e administrimit të rrezikut për të gjithë portofolin dhe për çdo klient në veçanti, kufijtë e kredisë për një klient, përqendrimin e kredisë sipas sektorëve, monitorimin sipas objektit dhe llojit të kredisë, analizën e mospërputhjeve të ndjeshme mes portofolit të kredisë dhe burimeve të financimit të tij përsa i takon afateve dhe llojit të monedhës, në drejtim të vlerësimit të lidhjes mes rrezikut të kredisë dhe rreziqeve të tjera (ndryshimi i kursit të këmbimit, ndryshimi i normës së interesit etj.);

f) procedurat për ndjekjen në vazhdimësi të mbarëvajtjes së kredive dhe identifikimin e tyre sipas grupeve të kredive me karakteristika të njëjta, për ndjekjen me përparësi të kredive me probleme, për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga kreditë, kriteret për ristrukturimin e kredive;

g) procedurat për vlerësimin e cilësisë së aktiveve të tjera, për llogaritjen e fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga zhvlerësimi i aktiveve, si dhe për vlerësimin e mjaftueshmërisë së tyre.

3. Subjektet financiare jobanka ruajnë në dosje të veçanta, të gjithë dokumentacionin përkatës për kredimarrësit.

NËNKREU II

ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË KREDISË NË SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA

Neni 11

Klasifikimi i kredisë

1. Subjektet financiare jobanka të licencuara për ushtrimin e aktivitetit kredidhënës, me përjashtim të institucioneve financiare të mikrokredisë, bëjnë klasifikimin e kredisë të paktën një herë në tre muaj.

2. Subjektet financiare jobanka, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kredisë, i klasifikojnë ato në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) “kredi standarde”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 1 deri 30 ditësh nga afati i maturimit;

b) “kredi në ndjekje”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 31 deri 90 ditësh nga afati i maturimit;

c) “kredi nënstandarde”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 91 deri 180 ditësh nga afati i maturimit;

d) “kredi të dyshimta”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 181 deri 365 ditësh nga afati i maturimit;

e) “kredi të humbura”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 ditësh nga afati i maturimit.

Neni 12

Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

1. Në varësi të kategorive të klasifikimit të kredive, subjektet financiare jobanka krijojnë fonde përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga moskthimi i kredive.

2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen respektivisht si më poshtë:

a) për “kreditë standarde” 1 për qind;

b) për “kreditë në ndjekje” 5 për qind;

c) për “kreditë nënstandarde” jo më pak se 20 për qind;

d) për “kreditë e dyshimta” jo më pak se 50 për qind;

e) për “kreditë e humbur” jo më pak se 100 për qind.

3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, për dy kategoritë e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2, të këtij neni, do të aplikohet njëlloj si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kreditë me probleme, norma e aplikuar mbi interesin e përlllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.

4. Subjekti financiar jobankë nuk kontabilizon interesat e përlllogaritur duke filluar nga momenti i klasifikimit të kredisë si kredi me probleme.

Neni 13

Ristrukturimi i kredisë

1. Subjektet financiare jobanka, në marrëveshje me kredimarrësin, rristrukojnë kreditë në rastin kur kredimarrësi nuk shlyen kreditë në përputhje me afatet dhe me kushtet e marrëveshjes fillestare, sipas kriterëve të përcaktuara në manualin e kredisë të miratuar nga organet drejtuese të subjektit financiar jobankë dhe/ose kur mbështetur në analizat e tyre, gjykojnë se kredimarrësi do ta paguajë (shlyejë) të gjithë kreditë sipas kushteve të reja.

2. Kredia e rristrukuar klasifikohet në një kategori më të lartë se ajo nënstandarde, vetëm në rast se plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) kredia po shlyhet për vlerën e kryegjësë dhe të interesit, sipas kushteve të reja;

b) kanë kaluar më tepër se 365 ditë nga dita e rristruimit.

3. Për riklasifikimin në rritje të një kredie brenda grupit të kredive me probleme, pas rristruimit të saj, subjekti financiar jobankë përcakton në manualin e brendshme të tij kriteret dhe kohën e nevojshme për t’u siguruar që kredimarrësi po shlyen kreditë në përputhje me kushtet e reja së saj.

Neni 14

Fshirja e kredive të humbura

1. Fshirja e kredive të humbura bëhet me vendim të organeve drejtuese të subjektit financiar jobankë, kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) subjekti financiar jobankë ka përfunduar procesin ligjor të kërimit të kthimit të kredisë nga kredimarrësi dhe kredimarrësi është debitor për pjesën e pashlyer;

b) kur kredia është e klasifikuar si “e humbur” dhe nuk është shlyer për më tepër se 365 ditë pas klasifikimit si e tillë;

c) kredia është vlerësuar si e humbur nga inspektorët e mbikëqyrjes dhe në raportin e inspektimit, është kërkuar fshirja e saj.

2. Dosjet e kredive të fshira, ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në gjashtë muaj nga organet drejtuese të subjektit financiar jobankë. Çdo arkëtim nga këto kredi të fshira konsiderohet si e ardhur e jashtëzakonshme.

NËNKREU III
ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË KREDISË
NË INSTITUCIONET FINANCIARE TË MIKROKREDISË

Neni 15

Klasifikimi i kredive për institucionet financiare të mikro-kredisë

Institucionet financiare të mikro-kredisë bëjnë klasifikimin e kredive, të paktën një herë në tre muaj.

1. Institucionet financiare të mikro-kredisë, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kredisë, i klasifikojnë ato në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) “kredi standarde”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 1 deri 30 ditësh nga afati i maturimit;

b) “kredi nënstandarde”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 31 deri 90 ditësh nga afati i maturimit;

c) “kredi të dyshimta”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 91 deri 365 ditësh nga afati i maturimit;

d) “kredi të humbura”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 ditësh nga afati i maturimit.

3. Çdo kredi e dhënë për të ripaguar një kredi tjetër së cilës i ka kaluar afati, kushtet e së cilës janë modifikuar pjesërisht, në rastin e zgjatjes së afatit të kredisë ose tërësisht si në rastin e ristrukturimit të kredisë për shkak të kushteve të vështira financiare të kredimarrësit apo paaftësisë së tij për të paguar, nuk duhet të klasifikohet në një kategori më të lartë se ajo nënstandarde.

4. Çdo kredi e dhënë në valutë të huaj klientëve të cilët nuk i kanë burimet e të ardhurave në valutë të huaj, nuk do të klasifikohet në një kategori më të lartë se kreditë nënstandarde.

5. Institucioni financiar i mikro-kredisë nuk miraton kredi të re/reja për kredimarrës të klasifikuar me probleme, derisa kredimarrësi të ketë paguar të gjithë kredinë bashkë me interesat përkatëse.

Neni 16

Llogaritja e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

1. Në varësi të kategorive të klasifikimit të kredive, institucionet financiare të mikro-kredisë krijojnë fonde përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga moskthimi i kredive.

2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen respektivisht si më poshtë:

- | | |
|-------------------------------|----------------------------|
| a) për “kredinë standarde” | 1 për qind; |
| b) për “kredinë nënstandarde” | jo më pak se 30 për qind; |
| c) për “kredinë e dyshimtë” | jo më pak se 75 për qind; |
| d) për “kredinë e humbur” | jo më pak se 100 për qind. |

3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, për kategorinë “standarde”, do të aplikohet njëjloj si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kredinë me probleme, norma e aplikuar mbi interesin e përlllogaritur do të jetë 100 për qind për çdo kategori.

Neni 17

Fshirja e kredive të humbura

1. Institucioni financiar i mikro-kredisë fshin kredinë nga bilanci kontabël, jo më vonë se tremujori i parë pasardhës, nëse kjo e fundit plotëson një nga kriteret e mëposhtme:

a) kredia është klasifikuar si kredi me probleme dhe institucioni financiar i mikrokredisë konstaton se kredimarrësi nuk do të mund të paguajë detyrimin që lidhet me kredinë;

b) kredimarrësi ka vdekur dhe nuk ka ndonjë trashëgimtar, garantues apo nënshkrues, i cili të mund të shlyejë detyrimin; ose

c) ripagimit (shlyerjes) të kryegjësë apo interesit të kredisë i ka kaluar afati 365 ditor;

d) kredia është vlerësuar si e humbur nga inspektorët e mbikëqyrjes dhe në raportin e inspektimit është kërkuar fshirja e saj.

2. Dosjet e kredive të fshira ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në gjashtë muaj nga organet drejtuese të institucionit financiar të mikrokredisë. Çdo arkëtim nga këto kredi të fshira konsiderohet si e ardhur e jashtëzakonshme.

KREU III ADMINISTRIMI I RREZIKUT NË SUBJEKTET QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E QIRASË FINANCIARE

Neni 18

Ekspozimi maksimal i lejueshëm

1. Ekspozimi i subjektit që ushtron veprimtarinë e qirasë financiare ndaj një personi ose grupi personash të lidhur konsiderohet ekspozim i madh kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 25 për qind e kapitalit të subjektit.

2. Subjekti nuk merr përsipër ekspozime të mëdha, të cilat të marra së bashku, tejkalojnë 1200 për qind të kapitalit të subjektit.

3. Subjektet hartojnë procedura administrative dhe kontabël, si dhe mekanizma të kontrollit të brendshëm për të identifikuar, regjistruar dhe monitoruar të gjitha ekspozimet e mëdha dhe ndryshimet e tyre.

KREU IV KËRKESA RAPORTUESE DHE MBIKËQYRËSE

Neni 19

Raportet financiare

1. Subjekti financiar jobankë mban llogaritë kontabël dhe përgatit raportet financiare për pasqyrimin e saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat kontabël të gjendjes së tij financiare, mbi baza individuale ose të konsoliduara.

2. Llogaritë kontabël dhe raportet financiare përgatiten në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar në ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Neni 20

Auditimi i ekspertit kontabël të autorizuar

1. Eksperti kontabël i autorizuar kontrollon dhe vlerëson përputhshmërinë e raporteve financiare të subjektit financiar jobankë me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

2. Eksperti kontabël i autorizuar kontrollon dhe vlerëson:

- a) llogarinë e humbje-fitimit (pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve);
- b) bilancin kontabël;
- c) raportin për ndryshimet në kapital;
- d) pasqyrën e cash – flow;
- e) zbatimin e politikave të fshirjes së zërave të bilancit;
- f) raportet e konsoliduara;

- g) funksionin e kontrollit të brendshëm;
- h) regjistrimet kontabël;
- i) sistemet e informacionit;
- j) saktësinë dhe plotësimin e raporteve të paraqitura në Bankën e Shqipërisë;
- k) mjaftueshmërinë e procedurave kontabël dhe zbatimin e rregulloreve;
- l) shënimet që shoqërojnë raportet financiare.

Eksperti kontabël i autorizuar verifikon saktësinë e mbajtjes të llogarive kontabël dhe të regjistrimeve financiare, përfshirë metodat e parashikuara nga Banka e Shqipërisë si dhe përgatit një raport vjetor, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjendjes financiare të subjektit financiar jobankë, duke u bazuar në raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga subjekti, në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Neni 21

Raportimi në Bankën e Shqipërisë

1. Subjektet financiare jobanka raportojnë në Bankën e Shqipërisë sipas kërkesave të përcaktuara në “Sistemin raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”, të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

2. Subjektet financiare jobanka dërgojnë në Bankën e Shqipërisë, brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, një kopje të raportit vjetor dhe të opinionit të ekspertit kontabël të autorizuar, ku pasqyrohet gjendja financiare dhe kontabël mbi baza individuale dhe të konsoliduara.

Neni 22

Masat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse të parashikuara në ligjin për bankat.

KREU V

Neni 23

Dispozitë e fundit

Aneksi bashkëlidhur kësaj rregulloreje është pjesë përbërëse e saj.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

ANEKS I

LISTA E VENDEVE TË “OECD”

1. Australi
2. Austri
3. Belgjikë
4. Britani e Madhe
5. Kanada
6. Republika Çeke
7. Danimarkë
8. Finlandë
9. Francë
10. Gjermani
11. Greqi
12. Hungari
13. Islandë
14. Irlandë
15. Itali
16. Japoni
17. Republika e Koresë
18. Luksemburg
19. Meksikë
20. Turqi
21. Holandë
22. Norvegji
23. Poloni
24. Portugali
25. Sllovaki
26. Spanjë
27. Suedi
28. Shtetet e Bashkuara të Amerikës
29. Zelandë e Re
30. Zvicër.

VENDIM

Nr.26, datë 14.4.2010

PËR MIRATIMIN E “SISTEMIT RAPORTUES PËR SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 27 dhe të nenit 43, germa “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 126, pika 4 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit të Statistikave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Sistemin raportues për subjektet financiare jobanka” sipas formularëve vijues bashkëlidhur këtij vendimi:

- a) Formulari 1: “Lista e aktiveve”,
- b) Formulari 2: “Lista e pasiveve”,
- c) Formulari 3: “Llogaria fitim-humbje”,
- d) Formulari 4: “Tregues të tjerë”,
- e) Formulari 5: “Mjaftueshmëria e kapitalit”,
- f) Formulari 6: “Ekspozimi ndaj rrezikut dhe kufizimet”,
- g) Formulari 7: “Ekspozimi maksimal i lejueshëm”,
- h) Formulari 8: “Rreziku i likuiditetit”,
- i) Formulari 9: “Normat e lejueshme për pozicionet e hapura valutore”,
- j) Formulari 10: “Klasifikimi i kredive dhe llogaritja e provigjoneve”,
- k) Formulari 11: “Tregues të ndryshëm”,
- l) Formulari 12: “Evidenca e kreditit sipas degëve të ekonomisë”,
- m) Formulari 13: “Evidenca e kreditit sipas afatit të maturimit”,
- n) Formulari 14: “Kredia sipas monedhës dhe llojit të kolateralit”,
- o) Formulari 15 “Numri i rretheve ku operon subjekti”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 32, datë 27.4.2005 për miratimin e “Sistemit raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RAPORTIME TREMUJORE

Afati i raportimit jo më vonë se 40 ditë mbas mbylljes së tremujorit

Formulari 1

Kodi	AKTIVET (në mijë lekë)	Fondi i Amortizimit & Provigione (-A)	LEKË		VALUTË		TOTALI
			Rezident	Jorezident	Rezident	Jorezident	
1	Arka, depozitat dhe llogaritë		-	-	-	-	-
1.1	Arka dhe vlera të tjera arke						-
1.2	Llogari rrjedhëse në korporatat depozituese		-	-	-	-	-
1.2.1	Llogari rrjedhëse në korporatat depozituese						-
1.2.2	Interesi i përlllogaritur						-
1.3	Depozitat pa afat në korporatat depozituese		-	-	-	-	-
1.3.1	Depozitat pa afat në korporatat depozituese						-
1.3.2	Interesi i përlllogaritur						-
1.4	Depozitat me afat dhe certifikatat e depozitave në korporatat depozituese		-	-	-	-	-
1.4.1	Depozitat me afat dhe certifikatat e depozitave në korporatat depozituese						-
1.4.2	Interesi i përlllogaritur						-
1.5	Llogari të tjera dhe llogari garancie		-	-	-	-	-
1.5.1	Llogari të tjera dhe llogari garancie në banka						-
1.5.2	Llogari të tjera dhe llogari garancie në institucionet e tjera financiare						-
2	Letra me vlerë me të ardhura fikse		-	-	-	-	-
2.1	Letra me vlerë të qeverisë qendrore		-	-	-	-	-
2.1.1	Bono thesari		-	-	-	-	-

2.1.1.1	Bono thesari							-
2.1.1.2	Skontoja e bonove të thesarit							-
2.1.2	Letra me vlerë të tjera të qeverisë							-
2.2	<i>Letra me vlerë të korporatave depozituese</i>							-
2.3	<i>Letra me vlerë të institucioneve të tjera financiare</i>							-
2.4	<i>Letra me vlerë të korporatave jofinanciare publike</i>							-
2.5	<i>Letra me vlerë të korporatave të tjera jofinanciare</i>							-
3	Veprimet me klientët	-	-	-	-	-	-	-
3.1	Kredi standarde dhe paradhënie të papaguara në afat për klientët	-	-	-	-	-	-	-
3.1.1	<i>Kredi dhënë korporatave depozituese</i>							-
3.1.1.1	Kredi dhënë korporatave depozituese		-	-	-	-	-	-
3.1.1.2	Interesi i përlogaritur							-
3.1.2	<i>Kredi dhënë institucioneve të tjera financiare</i>							-
3.1.2.1	Kredi dhënë institucioneve të tjera financiare		-	-	-	-	-	-
3.1.2.2	Interesi i përlogaritur							-
3.1.3	<i>Kredi dhënë qeverisë lokale</i>							-
3.1.3.1	Kredi dhënë qeverisë lokale		-	-	-	-	-	-
3.1.3.2	Interesi i përlogaritur							-
3.1.4	<i>Kredi dhënë korporatave jofinanciare publike</i>							-
3.1.4.1	Kredi dhënë korporatave jofinanciare publike		-	-	-	-	-	-
3.1.4.2	Interesi i përlogaritur							-

3.1.5	<i>Kredi dhënë korporatave të tjera jofinanciare</i>		-	-	-	-	-
3.1.5.1	Kredi dhënë korporatave të tjera jofinanciare						-
3.1.5.2	Interesi i përlogaritur						-
3.1.6	<i>Kredi dhënë sektorëve të tjerë rezidentë</i>		-	-	-	-	-
3.1.6.1	Kredi dhënë sektorëve të tjerë rezidentë						-
3.1.6.2	Interesi i përlogaritur						-
3.1.7	<i>Fonde rezervë për huatë standarde</i>						-
3.2	Kredi dhe paradhënie në ndjekje	-	-	-	-	-	-
3.2.1	<i>Kredi dhënë korporatave depozituese</i>		-	-	-	-	-
3.2.1.1	Kredi dhënë korporatave depozituese						-
3.2.1.2	Interesi i përlogaritur						-
3.2.2	<i>Kredi dhënë institucioneve të tjera financiare</i>		-	-	-	-	-
3.2.2.1	Kredi dhënë institucioneve të tjera financiare						-
3.2.2.2	Interesi i përlogaritur						-
3.2.3	<i>Kredi dhënë qeverisë lokale</i>		-	-	-	-	-
3.2.3.1	Kredi dhënë qeverisë lokale						-
3.2.3.2	Interesi i përlogaritur						-
3.2.4	<i>Kredi dhënë korporatave jofinanciare publike</i>		-	-	-	-	-
3.2.4.1	Kredi dhënë korporatave jofinanciare publike						-
3.2.4.2	Interesi i përlogaritur						-

3.2.5	<i>Kredi dhënë korporatave të tjera jofinanciare</i>		-	-	-	-	-
3.2.5.1	Kredi dhënë korporatave të tjera jofinanciare						-
3.2.5.2	Interesi i përlogaritur						-
3.2.6	<i>Kredi dhënë sektorëve të tjerë rezidentë</i>		-	-	-	-	-
3.2.6.1	Kredi dhënë sektorëve të tjerë rezidentë						-
3.2.6.2	Interesi i përlogaritur						-
3.2.7	<i>Fonde rezervë për huatë në ndjekje</i>						-
3.3	Kredi nënstandard	-	-	-	-	-	-
3.3.1	<i>Kredi dhënë korporatave depozituese</i>		-	-	-	-	-
3.3.1.1	Kredi dhënë korporatave depozituese						-
3.3.1.2	Interesi i përlogaritur						-
3.3.2	<i>Kredi dhënë institucioneve të tjera financiare</i>		-	-	-	-	-
3.3.2.1	Kredi dhënë institucioneve të tjera financiare						-
3.3.2.2	Interesi i përlogaritur						-
3.3.3	<i>Kredi dhënë qeverisë lokale</i>		-	-	-	-	-
3.3.3.1	Kredi dhënë qeverisë lokale						-
3.3.3.2	Interesi i përlogaritur						-
3.3.4	<i>Kredi dhënë korporatave jofinanciare publike</i>		-	-	-	-	-
3.3.4.1	Kredi dhënë korporatave jofinanciare publike						-
3.3.4.2	Interesi i përlogaritur						-
3.3.5	<i>Kredi dhënë korporatave të tjera jofinanciare</i>		-	-	-	-	-

3.3.5.1	Kredi dhënë korporatave të tjera jofinanciare							-
3.3.5.2	Interesi i përlogaritur							-
3.3.6	<i>Kredi dhënë sektorëve të tjerë rezidentë</i>							-
3.3.6.1	Kredi dhënë sektorëve të tjerë rezidentë		-	-	-	-	-	-
3.3.6.2	Interesi i përlogaritur							-
3.3.7	<i>Fonde rezervë për huatë nënstandard</i>							-
3.3.7.1	- Për kryegjënë	-						-
3.3.7.2	-Për interesin e përlogaritur							-
3.4	Kredi të dyshimta	-	-	-	-	-	-	-
3.4.1	<i>Kredi dhënë korporatave depozituese</i>							-
3.4.1.1	Kredi dhënë korporatave depozituese		-	-	-	-	-	-
3.4.1.2	Interesi i përlogaritur							-
3.4.2	<i>Kredi dhënë institucioneve të tjera financiare</i>							-
3.4.2.1	Kredi dhënë institucioneve të tjera financiare		-	-	-	-	-	-
3.4.2.2	Interesi i përlogaritur							-
3.4.3	<i>Kredi dhënë qeverisë lokale</i>							-
3.4.3.1	Kredi dhënë qeverisë lokale		-	-	-	-	-	-
3.4.3.2	Interesi i përlogaritur							-
3.4.4	<i>Kredi dhënë korporatave jofinanciare publike</i>							-
3.4.4.1	Kredi dhënë korporatave jofinanciare publike		-	-	-	-	-	-
3.4.4.2	Interesi i përlogaritur							-

3.4.5	<i>Kredi dhënë korporatave të tjera jofinanciare</i>		-	-	-	-	-
3.4.5.1	Kredi dhënë korporatave të tjera jofinanciare						-
3.4.5.2	Interesi i përllogaritur						-
3.4.6	<i>Kredi dhënë sektorëve të tjerë rezidentë</i>		-	-	-	-	-
3.4.6.1	Kredi dhënë sektorëve të tjerë rezidentë						-
3.4.6.2	Interesi i përllogaritur						-
3.4.7	<i>Fonde rezervë për huatë e dyshimta</i>						-
3.4.7.1	- Për kryegjënë	-					-
3.4.7.2	-Për interesin e përllogaritur						-
3.5	Kredi të humbura	-	-	-	-	-	-
3.5.1	<i>Kredi dhënë korporatave depozituese</i>		-	-	-	-	-
3.5.1.1	Kredi dhënë korporatave depozituese						-
3.5.1.2	Interesi i përllogaritur						-
3.5.2	<i>Kredi dhënë institucioneve të tjera financiare</i>		-	-	-	-	-
3.5.2.1	Kredi dhënë institucioneve të tjera financiare						-
3.5.2.2	Interesi i përllogaritur						-
3.5.3	<i>Kredi dhënë qeverisë lokale</i>		-	-	-	-	-
3.5.3.1	Kredi dhënë qeverisë lokale						-
3.5.3.2	Interesi i përllogaritur						-
3.5.4	<i>Kredi dhënë korporatave jofinanciare publike</i>		-	-	-	-	-

3.5.4.1	Kredi dhënë korporatave jofinanciare publike							-
3.5.4.2	Interesi i përlogaritur							-
3.5.5	<i>Kredi dhënë korporatave të tjera jofinanciare</i>							-
3.5.5.1	Kredi dhënë korporatave të tjera jofinanciare		-	-	-	-		-
3.5.5.2	Interesi i përlogaritur							-
3.5.6	<i>Kredi dhënë sektorëve të tjerë rezidentë</i>							-
3.5.6.1	Kredi dhënë sektorëve të tjerë rezidentë		-	-	-	-		-
3.5.6.2	Interesi i përlogaritur							-
3.5.7	<i>Fonde rezervë për huatë e humbura</i>							-
	- Për kryegjënë	-						-
	-Për interesin e përlogaritur							-
4	Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
4.1	<i>Aksione dhe instrumente të tjera të kapitalit në korporatat depozituese</i>							-
4.2	<i>Aksione dhe instrumente të tjera të kapitalit në institucionet e tjera financiare</i>							-
4.3	<i>Aksione dhe instrumente të tjera të kapitalit në korporatat jofinanciare publike</i>							-
4.4	<i>Aksione dhe instrumente të tjera të kapitalit në korporatat e tjera jofinanciare</i>							-
4.5	<i>Aksione dhe instrumente të tjera të kapitalit në sektorë të tjerë rezidentë</i>							-
5	Të tjera të arkëtueshme							-
6	Mjete jofinanciare	-	-	-	-	-	-	-
6.1	<i>Aktive të qëndrueshme të trupëzuara (neto)</i>	-	-	-	-	-	-	-

6.1.1	Aktive të qëndrueshme të trupëzuara						-
6.1.9	(-) Zhvlerësimi i akumuluar i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara						-
6.2	<i>Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara (neto)</i>	-	-	-	-	-	-
6.2.1	Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara						-
6.2.9	(-) Amortizimi i akumuluar i aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara						-
6.3	<i>Mjete të tjera jofinanciare</i>						-
	Totali	-	-	-	-	-	-

Formulari 2

Kodi	PASIVET (në mijë lekë)	LEKË		VALUTË		TOTALI
		Rezident	Jorezident	Rezident	Jorezident	
1	Llogari rrjedhëse dhe llogari garancie	-	-	-	-	-
1.1	Llogari rrjedhëse dhe llogari garancie të korporatave depozituese					-
1.2	Llogari rrjedhëse dhe llogari garancie të institucioneve të tjera financiare					-
1.3	Llogari rrjedhëse dhe llogari garancie të korporatave jofinanciare publike					-
1.4	Llogari rrjedhëse dhe llogari garancie të korporatave të tjera jofinanciare					-
1.5	Llogari rrjedhëse dhe llogari garancie të sektorëve të tjerë rezidentë					-
2	Kredi të marra	-	-	-	-	-
2.1	Kredi të marra nga qeveria qendrore	-	-	-	-	-
2.1.1	Kredi të marra nga qeveria qendrore					-
2.1.2	Interesi i përllogaritur					-
2.2	Kredi të marra nga korporatat depozituese	-	-	-	-	-
2.2.1	Kredi të marra nga korporatat depozituese					-
2.2.2	Interesi i përllogaritur					-
2.3	Kredi të marra nga institucionet e tjera financiare	-	-	-	-	-
2.3.1	Kredi të marra nga institucionet e tjera financiare					-
2.3.2	Interesi i përllogaritur					-
2.4	Kredi të marra nga korporatat jofinanciare publike	-	-	-	-	-
2.4.1	Kredi të marra nga korporatat jofinanciare publike					-
2.4.2	Interesi i përllogaritur					-
2.5	Kredi të marra nga korporatat e tjera jofinanciare	-	-	-	-	-
2.5.1	Kredi të marra nga korporatat e tjera jofinanciare					-
2.5.2	Interesi i përllogaritur					-
2.6	Kredi të marra nga sektorë të tjerë rezidentë	-	-	-	-	-
2.6.1	Kredi të marra nga sektorë të tjerë rezidentë					-
2.6.2	Interesi i përllogaritur					-
3	Kredimarrje nëpërmjet letrave me vlerë					-
4	Ndihmat	-	-	-	-	-
4.1	Ndihma të marra					-

4.2	<i>Pjesa e grumbulluar e ndihmave kaluar në të ardhura</i>					-
5	Të tjera të pagueshme					-
6	Llogaritë kapitale	-	-	-	-	-
6.1	<i>Kapitali i paguar</i>					-
6.2	<i>Primet e aksioneve</i>					-
6.3	<i>Rezervat</i>					-
6.4	<i>Diferenca rivlerësimi</i>					-
6.5	<i>Fitimet e pashpërndara</i>					-
6.6	<i>Fitim humbja e vitit ushtrimor</i>					-
	TOTALI	-	-	-	-	-

Formulari 3

Kodi	LLOGARIA FITIM - HUMBJE <i>(në mijë lekë)</i>	LEKË	VALUTË	TOTALI
	TË ARDHURAT			
1	Të ardhurat nga interesi	-	-	-
1.1	Nga depozitat dhe llogaritë rrjedhëse në korporatat depozituese			-
1.2	Nga letrat me vlerë përveç aksioneve			-
1.3	Nga veprimet me klientët			-
1.4	Të tjera			-
2	Të ardhura nga komisionet	-	-	-
2.1	Nga depozitat dhe llogaritë rrjedhëse në korporatat depozituese			-
2.2	Nga letrat me vlerë përveç aksioneve			-
2.3	Nga veprimet me klientët			-
2.4	Nga aksionet dhe instrumente të tjera të kapitalit			-
2.5	Të tjera			-
3	Të ardhura të tjera nga letrat me vlerë dhe veprimtaritë e tjera financiare			-
4	Të ardhura të tjera të veprimtarisë			-
5	Fitime nga veprimet me valutat			-
6	Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme			-
7	Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin e llogarive për t'u arkëtuar	-	-	-
7.1	Transferime nga fondet rezervë të krijuara për veprimet me klientët	-	-	-
7.1.1	Për huatë standarde dhe paradhënie të papaguara në afat			-
7.1.2	Për huatë dhe paradhëniet në ndjekje			-
7.1.3	Për huatë nënstandard			-
7.1.4	Për huatë e dyshimta			-
7.1.5	Për huatë e humbura			-

7.2	Transferime nga fondet rezervë të krijuara për letrat me vlerë			-
7.3	Të tjera transferime nga fondet rezervë të krijuara			-
8	Të ardhura të jashtëzakonshme			-
9	Humbja e vitit në vazhdim			-
	Totali i të ardhurave	-	-	-
	SHPENZIMET			
1	Shpenzime për interesa	-	-	-
1.1	Për llogaritë e tjera			-
1.2	Për kreditë e marra			-
1.3	Të tjera			-
2	Shpenzime për komisione	-	-	-
2.1	Për llogaritë e tjera			-
2.2	Për kreditë e marra			-
2.3	Të tjera			-
3	Humbje nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimtaritë e tjera financiare			-
4	Shpenzime të tjera të veprimtarisë			-
5	Humbje nga veprimet me valutat			-
6	Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë	-	-	-
6.1	Kosto e personelit			-
6.2	Taksa përveç taksave mbi të ardhurat			-
6.3	Shpenzime të tjera administrative			-
7	Amortizimi dhe fondet rezervë për zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme			-
8	Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme, shpenzime për fonde rezervë	-	-	-
8.1	Shpenzime për fonde rezervë për huatë	-	-	-
8.1.1	Standarde dhe paradhënie të papaguara në afat			-
8.1.2	Në ndjekje			-
8.1.3	Nënstandard			-
8.1.4	Të dyshimta			-
8.1.5	Të humbura			-
8.2	Shpenzime për fonde rezervë të krijuara për letrat me vlerë			-
8.3	Llogari për t'u arkëtuar të pambledhshme			-
8.4	Të tjera shpenzime për fonde rezervë të krijuara			-
9	Shpenzime të jashtëzakonshme			-
10	Taksa mbi të ardhurat			-
11	Fitimi i vitit në vazhdim			-
	Totali i shpenzimeve	-	-	-

Formulari 4

Kodi	TREGUES TË TJERË (në mijë lekë)	SHUMA
1	Aktive me maturim të mbetur deri në një muaj	
2	Detyrime me maturim të mbetur deri në një muaj	
3	Aktive me maturim të mbetur deri në tre muaj	
4	Detyrime me maturim të mbetur deri në tre muaj	
5	Teprica e kredisë me maturim të mbetur mbi dy vjet	
6	Burimet e financimit me maturim të mbetur mbi dy vjet	
7	Aktive që sjellin të ardhura	
8	Pasive që shkaktojnë shpenzime	

Formulari 5

Kodi	MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT (në %)	NORMA	TREGUESI I LLOGARITUR
1	Kapitali / Totali i aktiveve Në vitin e parë Në vitin e dytë Në vazhdim	jo më pak se 5 jo më pak se 8 jo më pak se 10	
2	Kapitali / Totali i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara neto	jo më pak se 100	
3	Kapitali / Totali i kredive me probleme (neto)	jo më pak se 100	

Shënim : Ky formular nuk plotësohet nga subjektet financiare jobanka që ushtrojnë veprimtarinë e qirasë financiare.

Formulari 6

Kodi	EKSPOZIMI NDAJ RREZIKUT DHE KUFIZIMET (në %)	NORMA	TREGUESI I LLOGARITUR
1	Kredi me probleme / Totali i kredive	jo më shumë se 10	
2	Kredi të fshira (duke zbritur arkëtimet) / Teprica mesatare e kredive, për çdo periudhë 12-mujore	jo më shumë se 3	
3	Aktiveve të qëndrueshme (neto) / Totali i aktiveve Në vitin e parë Në vazhdim	jo më shumë se 20 jo më shumë se 10	
4	Aktive që sjellin të ardhura / Detyrime që shkaktajnë shpenzime	jo më pak se 100	
5	Totali i kredive / Totali i aktiveve	jo më shumë se 95	
6	Çdo investim në tituj (me përjashtim të titujve të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe qeveritë dhe/ose bankat qendrore të vendeve të OECD)		
	- Letra me vlerë të subjektit A / Kapitalit të subjektit - Letra me vlerë të subjektit B / Kapitalit të subjektit - etj. - - -	jo më shumë se 5	
7	Totali i investimeve mbi tituj / Kapitalit të subjektit	jo më shumë se 40	

Shënim: Ky formular nuk plotësohet nga subjektet financiare jobanka që ushtrojnë veprimtarinë e qirasë financiare.

Formulari 7

Kodi	EKSPOZIMI MAKSIMAL I LEJUESHËM (në %)	NORMA	TREGUESI I LLOGARITUR
1	Ekspozimi i subjektit ndaj një personi ose grup personash të lidhur - klienti A / Kapitalit të subjektit - klienti B / Kapitalit të subjektit - etj. - - - - - -	jo më shumë se 15	
2	Totali i ekspozimeve të mëdha / Kapitalit të subjektit	jo me shume se 600	

Shënim: Ky formular nuk plotësohet nga subjektet financiare jobanka që ushtrojnë veprimtarinë e qirasë financiare.
Shënim: në pikën 1 raportohen të gjitha ekspozimet ndaj një personi ose grup personash të lidhur, kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 10 për qind ekapitalit të subjektit.

Formulari 7

Kodi	EKSPOZIMI MAKSIMAL I LEJUESHËM (në %)	NORMA	TREGUESI I LLOGARITUR
1	Ekspozimi i subjektit ndaj një personi ose grup personash të lidhur - klienti A / Kapitalit të subjektit - klienti B / Kapitalit të subjektit - etj. - - - - -		
2	Totali i ekspozimeve të mëdha / Kapitalit të subjektit	jo me shume se 1200	

Shënime:

- në pikën 1 raportohen të gjitha ekspozimet ndaj një personi ose grup personash të lidhur kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 25 për qind e kapitalit të subjektit
- ky formular është i zbatueshëm vetëm për subjektet ushtrjnë veprimtarinë e qirasë financiare

Formulari 8

Kodi	RREZIKU I LIKUIDITETIT (në %)	NORMA	TREGUESI I LLOGARITUR
1	Aktive me maturim të mbetur njëmuor / Detyrime me maturim të mbetur njëmuor	jo më pak se 100	
2	Aktive me maturim të mbetur tremujor / Detyrime me maturim të mbetur tremujor	jo më pak se 100	
3	Kredi me afat maturimi të mbetur më shumë se dy vjet / Burime me afat maturimi të mbetur më shumë se dy vjet	jo më shumë se 100	

Shënim: Ky formular nuk plotësohet nga subjektet financiare jobanka që ushtrjnë veprimtarinë e qirasë financiare.

Formulari 9

Kodi	NORMAT E LEJUESHME PËR POZICIONET E HAPURA VALUTORE	Shuma në monedha të huaja (në mijë njësi)				Kursi i këmbimit	Ekuivalenti në Lek i pozicionit neto	Pozicioni neto / kapitalit të subjektit (në %)
		Te drejtat	Detyrimet	Pozicioni neto				
				Në blerje	Në shitje			
	USD EURO GBP CHF CAD SEK AUD YEN DKK NOK							#DIV/0! #DIV/0! #DIV/0! #DIV/0! #DIV/0! #DIV/0! #DIV/0! #DIV/0! #DIV/0! #DIV/0!
	1. Shuma e pozicioneve në shitje 2. Shuma e pozicioneve në blerje Pozicioni neto për të gjitha monedhat (2 - 1) Pozicioni neto në total (në % ndaj kapitalit të subjektit) Kapitali i subjektit Norma e miratuar për një monedhë Norma e miratuar për të gjitha monedhat së bashku							0 #DIV/0! 20 30

Shënim: Ky formular nuk plotësohet nga subjektet financiare jobanka që ushtrojnë veprimtarinë e qirasë financiare.

Formulari 10

Kodi	KLASIFIKIMI I KREDIVE DHE LLOGARITJA E PROVIGJONEVE	Kryegjëja			Interesi i përllogaritur			Numri i kredimarrësve
		Norma e provigjonimit	Në mijë lekë		Norma e provigjonimit	Në mijë lekë		
			Shuma e kredisë	Shuma e provigjoneve		Shuma e interesit	Shuma e provigjoneve	
1	Kredi standarde	1 %			1 %			
2	Kredi në ndjekje	5 %			5 %			
3	Kredi nënstandarde	jo më pak se 20%			100 %			
4	Kredi të dyshimta	jo më pak se 50%			100 %			
5	Kredi të humbura	jo më pak se 100%			100 %			
	TOTALI		-	-		-	-	-
5	Kredi me probleme (3+4+5)		-	-		-	-	-

Shënim: Ky formular nuk plotësohet nga subjektet financiare jobanka që ushtrojnë veprimtarinë e qirasë financiare.
Shënim: Ky formular është i zbatueshëm vetëm për institucionet financiare jobanka.

Formulari 10

Kodi	KLASIFIKIMI I KREDIVE DHE LLOGARITJA E PROVIGJONEVE	Kryegjësja			Interesi i përlogaritur			Numri i kredimarrësve
		Norma e provigjonimit	Në mijë lekë		Norma e provigjonimit	Në mijë lekë		
			Shuma e kredisë	Shuma e provigjoneve		Shuma e interesit	Shuma e provigjoneve	
1	Kredi standarde	1 %			1 %			
3	Kredi nënstandarde	jo më pak se 30%			100 %			
4	Kredi të dyshimta	jo më pak se 75%			100 %			
5	Kredi të humbura	jo më pak se 100%			100 %			
	TOTALI		-	-		-	-	-
5	Kredi me probleme (3+4+5)		-	-		-	-	-

Shënim: Ky formular është i zbatueshëm vetëm për institucionet financiare të mikrokredisë.

Formulari 11

Kodi	TREGUES TË NDRYSHËM		SHUMA
1	Totali i "mikrokredive" (në mijë lekë)		
2	Totali i portofolit të kredive (në mijë lekë)		
3	Totali i mikrokredive / totalit të portofolit të kredive*100	(jo më i vogël se 50%)	#DIV/0!
4	Totali i portofolit të kredive / numri i kredimarrësve	(jo më i madh = se 600 000 lekë)	#DIV/0!

Shënim: Ky formular është i zbatueshëm vetëm për institucionet financiare të mikrokredisë.

Formulari 12

NACE Kodi i industrisë	Evidenca e kreditit sipas degëve të ekonomisë		Kredi e re (për muajin)	Teprica e kredisë gjithsej në fund të periudhës*
	Degët e ekonomisë			
1	Bizneset		-	-
A.	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura			
B.	Peshkimi			
C.	Industria nxjerrëse			
D.	Industria përpunuese			
E.	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit			
F.	Ndërtimi			
G.	Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiakë			
H.	Hotelet dhe restorantet			
I.	Transporti, magazinimi dhe telekomunikacioni			
J.	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar			
K.	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira etj.			
L.	Administrimi publik			
M.	Arsimi			
N.	Shëndeti dhe veprimtaritë sociale			
O.	Shërbime kolektive, sociale dhe individuale			
P,Q	Të tjera			
2	Individët			
	Totali		-	-

* duhet të jetë e barabartë me tepricën e kredisë raportuar në formularin 1 (pa zbritur provigjonet e krijuara dhe pa përfshirë interesat e përllogaritura)

Formulari 13

	Evidenca e kreditit sipas afatit të maturimit	Kredi e re (për muajin)	Teprica e kredisë gjithsej në fund të periudhës*
	Teprica e kredisë gjithsej (bruto)	-	-
	Kredi me afat deri në 12 muaj Kredi me afat 1 - 5 vjet Kredi me afat mbi 5 vjet		

* duhet të jetë e barabartë me tepricën e kredisë raportuar në formularin 1 (pa zbritur provigjonet e krijuara dhe pa përfshirë interesat e përllogaritura)

Formulari 14

Kodi	KREDIA SIPAS MONEDHËS DHE LLOJIT TË KOLATERALIT <i>(në mijë lekë)</i>	Kredi e kolateralizuar me pasuri të luajtshme	Kredi e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme	Kredi e kolateralizuar me cash	Kredi e pakolateralizuar
1	Teprica e kredisë në total				
2	Teprica e kredisë në lekë				
3	Teprica e kredisë në valutë				
4	Teprica e kredisë me probleme në total				
5	Teprica e kredisë me probleme në lekë				
6	Teprica e kredisë me probleme në valutë				

Formulari 15

Kodi	NUMRI I RRETHEVE KU OPERON SUBJEKTI	Numri
	Numri i rretheve në fillim të periudhës raportuese: Rrethet e reja gjatë periudhës raportuese(+) Numri i rretheve në fund të periudhës raportuese:	-

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 24.5.2010

Doli nga shtypi më 26.5.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë